



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600972/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** Rekomandojmë "*Propozime për shtesa dhe përmirësime të nenit 265 të Kodit Penal "Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve"*.

**Drejtuar :** Ministrit të Drejtësisë  
Z.Ylli MANJANI

**TIRANË**

**Për dijëni:** Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore,  
Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
Z. Fatmir XHAFA

**KUVENDI**

Prokurorit të Përgjithshëm  
Z.Adriatik LLALLA

**TIRANË**

*I nderuar Z. Ministër,*

Më datë 21 Shtator 1965, Asmableja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar Konventën Ndërkombëtare për Mënjanimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Kjo Konventë është cilësuar si traktati më i plotë dhe më i qartë për paraqitjen e idesë së barazisë racore. Në nenin 1 të Konventës thuhet: "Diskriminim racor do të thotë çdo lloj diskriminimi, kufizimi dhe privimi nga të drejtat shoqërore që bëhet në bazë të racës, ngjyrës, origjinës racore ose etnike dhe dëmton zbatimin e barazisë njerëzore dhe lirive themelore në sferën

politike, ekonomike, shqoërore , kulturore dhe në sferat e tjera përkatëse të jetës”.

Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës(ECRI) në Raportin Monitorues të botuar më datë 9 Qershor 2015, drejtuar Qeverisë shqiptare, ka paraqitur disa rekomandime, sugjerime dhe propozime lidhur me trajtimin e problematikave të identifikuara dhe përmirësimin e gjëndjes së racizmit dhe intolerancës në Shqipëri.

Ndërmjet këtyre rekomandimeve, në paragrafin 9 të Raportit, “ECRI rekomandon që autoritetet ta sjellin të drejtën penale në përgjithësi në përputhje me Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme nr.7 siç u specifikua në paragrafët më sipër ; në veçanti ato duhet të përfshijnë shkaqet e ngjyrës, gjuhës, shtetësisë dhe identitetit gjinor në dispozitat përkatëse dhe të parashikojnë si vepër penale nxitjen e dhunës, dhe diskriminimit për të gjitha shkaqet, mohimin public, degradimin, justifikimin ose harresën me qëllim racial, të krimeve të gjenocidit...”

Në nenin 265 të Kodit Penal “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, thuhet: “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe përgatitja , përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve me përmbajtje të tillë, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dhejtë vjet”

Megjithë ndryshimet e bëra në dispozitat e Kodit Penal në vitin 2016, lidhur me gjyken e urrejtjes, në nenin 265 nuk parashikohet nxitja e dhunës dhe diskriminimit. Mungojnë shkaqet e ngjyrës, gjuhës dhe shtetësisë, po ashtu mungon dhe identitetit gjinor. Për këto arsye mendojmë se në Kodin Penal pas nenit 265 të shtohet dhe një nen 265/1 në të cilën të parashikohet si vepër penale:

- i.Nxitja e dhunës dhe diskriminimit për të gjitha shkaqet;
- ii.mohimin public, degradimin, justifikimin ose harresën me qëllim racial të krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, ose krimeve të luftës;
- iii.përhapjen, prodhimin ose ruajtjen për qëllim përhapje të materialeve me figura dhe materialeve të tjera që përmbajnë manifestime raciale;
- iv.krijimin dhe drejtimin si dhe mbështetjen për dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e një grupi që promovon luftën kundër racizmit;
- v.diskriminimin racial gjatë ushtrimit të detyrave në sektorin privat.

Në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” si dhe nenit 24/a të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, ku thuhet se: “*Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut , të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera , ka të drejtë : a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjëvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve*”,

## REKOMANDOHET

1. Të ndërmerret iniciativa legjislative nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin e nenit 265 të Kodit Penal.

2. Sugjerojmë që pas nenit 265 të shtohet nenit 265/1 që parashikon si vepër penale:

***i. nxitja e dhunës për të gjitha shkaqet;***  
***ii. mohimin publik, degradimin, justifikimin ose harresën me qëllim racial të krimeve të genocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës;***  
***iii. përhapjen, prodhimin ose ruajtjen për qëllim përhapje të materialeve me figura dhe materialeve të tjera që përmbajnë manifestime raciale;***  
***iv. krijimin dhe drejtimin si dhe mbështetjen për, dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e një grupi që promovon luftën kundër racizmit;***  
***v. diskriminimin racial gjatë ushtrimit të detyrave në sektorin privat.***

Mbi mënyrën e shqyrtimit dhe masat e marra për Rekomandimin, lutemi të njoftohemi brenda 30 ditëve, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,*

**Me respekt**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**